



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. 41 prot.

Tiranë, me 09.01.2019

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Autoriteteve kontraktore zbatues të VKM 82/2018, i ndryshuar.

Për dijeni: Agjencisë së Prokurimit Publik

Tiranë

Të nderuar,

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (këtu e në vijim "ABP"), në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 82, datë 14.2.2018 "*Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime*", i ndryshuar, në cilësinë e Organit Qendror Blerës është ngarkuar për zhvillimin e procedurave të prokurimit, për mallrat dhe shërbimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, si vijon:

- 1.1. Blerje automjete;
- 1.2. Blerje karburanti, përveç vajgurit *Jet A1*;
- 1.3. Blerje materiale kancelarie;
- 1.4. Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh;
- 1.5. Blerje materiale të ndryshme për pastrim;
- 1.6. Blerje uniforma dhe elemente të tjera përbërëse të tyre;
- 1.7. Blerje këpucë;
- 1.8. Blerje pjesë këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;
- 1.9. Blerje tonera;
- 1.10. Sigurim automjete;
- 1.11. Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi;
- 1.12. Shërbim pastrimi;
- 1.13. Shërbim lyerjeje dhe mirëmbajtjeje ndërtesa;
- 1.14. Riparim dhe mirëmbajtje automjete;
- 1.15. Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;
- 1.16. Blerje materiale të buta dhe veshmbathje;

- 1.17. Riparim, mirëmbajtjeje sistemi të ngrohje-ftohjeve;
- 1.18. Mirëmbajtje impiante elektrike;
- 1.19. Blerje pajisje laboratorike, me përjashtim të atyre mjekësore;
- 1.20. Shërbime dezinfektimi;
- 1.21. Shërbim i ruajtjes dhe i sigurisë fizike;
- 1.22. Blerje artikuj ushqimorë;
- 1.23. Blerje pajisje kondicionimi;
- 1.24. Shërbim gjelbërimi.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 31.12.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.82, datë 14.2.2018 “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, me qëllim publikimin dhe zhvillimin pa vonesa të procedurave të prokurimit nga ana e Organit Qëndror Blerës, njoftojmë të gjitha autoritetet kontraktore zbatuese të këtij vendimi, si vijon:

I. Autoritetet kontraktore duhe të dërgojnë pranë ABP, sa më shpejt por jo më vonë se data 15 Janar 2019, të dhënat teknike e sasiore, fondin përkatës për mallrat e shërbimet që do të prokurohen nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, për secilin nga objektet e prokurimit:

1. Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1;
2. Blerje materiale kancelarie;
3. Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash;
4. Blerje materiale të ndryshme për pastrim;
5. Blerje pjesë këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;
6. Blerje tonerash;
7. Sigurim automjete;
8. Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;
9. Shërbime dezinfektimi;
10. Blerje uniforma dhe elemente të tjera përbërëse të tyre;
11. Blerje këpucë;
12. Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi;
13. Shërbim pastrimi;
14. Shërbim lyerjeje dhe mirëmbajtjeje ndërtesa.

I.1 Autoritetet kontraktore, për cdo objekt prokurimi duhet të dërgojnë **kërkesë të veçantë**, me shkrim dhe në format elektronik (me CD dhe në e-mail: ZhvillimiProkurimeve.ABP@mb.gov.al), ku të përcaktohen: objekti i prokurimit, afati dhe fondi i marrëveshjes kuadër (pa TVSH).

I.2 Kërkesa e vecantë për secilin objekt prokurimi, të shoqërohet me dokumentacionin e të dhënat e plota, si vijon:

a) Parashikimi i afatit dhe përllogaritja e fondit të marrëveshjes kuadër (pa TVSH).
Sqarojmë se, autoritetet kontraktore, duhet të dërgojnë kërkesat për prokurim nëpërmjet marrëveshjes kuadër **me afat të paktën 2 (dy) vjet**, dhe në cdo rast, fondi i përgjithshëm i marrëveshjes kuadër që do të dërgohet në organin qëndror blerës, duhet t’i referohet Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA) të autoritetit kontraktor;

b) Sasia dhe çmimi / njësi (pa TVSH);

- c) Specifikimet teknike dhe/ose termat e referencës, të hartuara nga të paktën 1 (një) specialist fushe, për mallrat dhe shërbimet të cilat nuk janë tëunifikuara.
- ç) Në rast të dërgimit të kritereve të veçanta të pranimi lidhur me kapacitetin teknik, për objekte specifike prokurimi, autoritetet kontraktore të përfshijnë specialistë fushe gjatë hartimit dhe të mirëargumentojnë vendosjen e cdo kriteri nga ana e tyre;
- d) Grafiku i lëvrimit të mallrave dhe/ose zbatimit të shërbimeve;
- dh) Për objektin e prokurimit “*Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1*”, të specifikohet nëse lëvrimi do të kryhet me kartë elektronike ose autobot;
- e) Të dhënat e kontaktit për personin /personat përgjegjës për prokurimin në autoritetin kontraktor (emër mbiemër, nr.telefoni, e-mail).

I.3 ABP ka unifikuar specifikimet teknike edhe çmimet për njësi, për objektet e mëposhtme të prokurimit:

- a) Blerje karburanti, përveç vajgurit *Jet A1*;
- b) Blerje materiale kancelarie;
- c) Blerje materiale të ndryshme për pastrim;
- ç) Sigurim automjete;
- d) Blerje tonera.

II. Autoritetet kontraktore duhet të dërgojnë pranë ABP, sa më shpejt por jo më vonë se data **15 Janar 2019**, të dhënat teknike e sasiore, fondin përkatës të mallrave, **për të lidhur Kontratë Publike**, për secilin nga objektet e prokurimit në vijim:

- a) Blerje automjete;
- b) Blerje pajisje laboratorike, me përjashtim të atyre mjekësore;
- c) Blerje materiale të buta dhe veshmbathje.

II.1 Autoritetet kontraktore, për cdo objekt prokurimi duhet të dërgojnë **kërkesë të veçantë**, me shkrim dhe në format elektronik (me CD dhe në e-mail: ZhvillimiProkurimeve.ABP@mb.gov.al), ku të përcaktohen: objekti i prokurimit dhe fondi limit (pa TVSH).

II.2 Kërkesa e vecantë për secilin objekt prokurimi, të shoqërohet me dokumentacionin e të dhënat e plota, si vijon:

- a) Përlllogaritja e fondit limit (pa TVSH);
- b) Sasia dhe çmimi / njësi (pa TVSH);
- c) Specifikimet teknike dhe/ose termat e referencës, të hartuara nga të paktën 1 (një) specialist fushe;
- ç) Në rast të dërgimit të kritereve të veçanta të pranimi lidhur me kapacitetin teknik, për objekte prokurimi specifike, autoritetet kontraktore të përfshijnë specialistë fushe gjatë hartimit dhe të mirëargumentojnë vendosjen e cdo kriteri nga ana e tyre;
- d) Grafiku i lëvrimit të mallrave dhe/ose zbatimit të shërbimeve në lidhje me to;
- dh) Të dhënat e kontaktit për personin / personat përgjegjës për prokurimin në autoritetin kontraktor (emër mbiemër, nr.telefoni, e-mail).

ABP do të informojë Agjencinë e Prokurimit Publik në çdo rast kur konstaton mosrespektimin e afateve kohore të përcaktuara në këtë njoftim.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

TITULLAR I ORGANIT QËNDROR BLERËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Edlira NAQELARI

